

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot. Br. prot./Prot.Nr.	2023/ZDP/202		
Faqe: Stranica/Pages	2	Kopje: Kopija/Copy	-
Datë: 07/06/2023		Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazno/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/intermo/internal	<input type="checkbox"/>		
			04/ZDP/VE/2023 Pristina

Datë: 07 qershor 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019), në pajtim me Shtojcën I, pika ATCO.A.020 dhe Shtojcën II pika ATCO.AR.A.010 (a) (1) të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe pikës 2.1 të procedurës AACK-SHNA-PC-5_ATC Licencing_Ver-6,

Duke marrë për bazë rekomandimin e Departamentit të Shërbimit të Navigimit Ajror lidhur me hetimin të ndodhisë së dt. 24 shkurt 2023,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. **PEZULLOHEN** gradimet APP të Kontrollorëve të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, me numër të licencave CAA015 me dt. të parë të lëshimit 18.03.2004 dhe CAA001 me dt. të parë të lëshimit 08.03.2004 .
2. **OBLIGOHET** departamenti i Shërbimeve të Navigimit Ajror të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me zbatim të këtij Vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi më ditën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri në marrjen e një Vendimi tjetër nga Drejtori i Përgjithshëm.

Arsyetim

Më dt. 24 shkurt 2023 ka ndodhur një incident me crast është aktivizuar TCAS RA ndërmjet dy fluturimeve IFR, aeroplanit GP Aviation Airlines (A/C) tip A 320 me shenjë thirrjeje GPX521 dhe aeroplanit të linjës ajrore Trade Air (A/C) tip A 319 me shenjë thirrjeje TDR2011, duke fluturuar në drejtim të kundërt në pjesën perëndimore të Kosovës, afër kufirit me Shqipërinë. Brenda afatit ligjor më dt. 27 shkurt 2023, ndodhia është raportuar në AAC nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA).

Pas pranimit të raportit të hetimeve nga AShNA më 6 prill 2023, nga ku kanë dalë 17 rekomandime të sigurisë, Departamenti i Shërbimit të Navigimit Ajror brenda AAC-së, për shkak të seriozitetit të incidentit vendosi të kryej edhe një hetim të pavarur.



Sipas analizës të Departamentit SHNA me elementet e përshkuara na raportin e dorëzuar është konstatuar që faktori kryesor nxitës për incidentin ishte gabimi njerëzor së bashku me shkaktar tjerë kontribuues.

Në raportin e dorëzuar nga Departamenti SHNA, është konstatuar që pas analizës së pavarur të ndodhisë, ky departament ka arritur në përfundim se performanca e kontrollorëve të përfshirë në incident, nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe nuk kanë zbatuar plotësisht procedurat e përcaktuara në Manualin e Kontrollit të Trafikut Ajror ver. 3.0.

Departamenti SHNA-së në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe pikës 2.1 të procedurës AACK-SHNA-PC-5_ATC Licencing_Ver-6,, ku përcaktohet që:

“AAC do të pezullojë përkohësisht licencën e kontrollorit të trafikut ajror kurdo që konsideron që:

- *Kompetenca për të ofruar një shërbim të trafikut ajror është në dyshim, dhe / ose*
- *Aftësia për të mbajtur licencën e kontrollorit të trafikut ajror është në dyshim”*

ka rekomanduar drejtorin e përgjithshëm të pezullojë gradimet APP të Kontrollorëve me nr. të licencave CAA015 (me dt.tw parë të lëshimit 18.03.2004) dhe CAA001 (me dt. të parë të lëshimit 18.03.2004), të përfshirë në incident. Për këtë arsye është rekomanduar që dy kontrollorët në fjalë t'i nënshtrohen një trajnimit përmirësues për të adresuar dobësitë e shfaqura. Pas këtij trajnimit duhet të kryhet një vlerësim i kompetencës dhe të kalohet me sukses ky vlerësim për të mundësuar heqjen e pezullimit të gradimeve të të dy kontrollorëve.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, me Shtojcën I, pika ATCO.A.020 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, pikës 2.1 të procedurës AACK-SHNA-PC-5_ATC Licencing_Ver-6, dhe rekomandimit të departamentit SHNA ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.



Iu dërgohet:

- Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Departamenti i Shërbimeve të Navigimit Ajror; dhe
- Arkivit të AAC-së.